



Pranuar / Dostiguar Primjenos/Pridata Received/Delivered	29. 12 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	8606/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.558/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2728/2019 të datës 11.11.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative të pranuar me date 12.12.2022, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.558/2019 të datës 20.09.2019, të parashtruar nga ankuesja _____ ne adresë Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 47/2019 të datës 30.08.2019 të komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestimi konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.558/2019 e datës 20.09.2019 e parashtruar nga ankuesja _____

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.47/2019 i datës 30.08.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme .

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 25.06.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Asistente Administrative", në QPD-së në Klinikë pranë Drejtorisë për Pajisje me Dokumente-ARC/MPB, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja dhe është përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit, në testin me shkrim dhe me gojë.

Me datë 31.07.2019 është publikuar njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, kundër të cilit njoftim ankuesja me datë 20.08.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili me datës 30.08.2019 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.47/2019 me numër të protokollit 377/19 me të cilin i është refuzuar ankesa e ankueses si e pa bazuar, duke lënë në fuqi Njoftimin

Nr.593/2019 të datës 31.07.2019 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatës së suksesshme në pozitën "Asistente Administrative", në QPD-së në Klinikë pranë Drejtorisë për Pajisje me Dokumente-ARC/MPB.

Ankuesja kundër Vendimit Nr.47/2019 të datës 30.08.2019 me numër të protokollit 377/19 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka parashtruar ankesë me datë 20.09.2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 4423/2019, me pretendime ankimore se Komisioni Përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësim real dhe te drejtë në testin me shkrim dhe me gojë respektivisht ajo pretendon se kandidatja e rekomanduar është mbivlerësuar, sepse tek arsimimi ajo është Magjistër i shkencave ekonomike (Mr.Sc) ndërsa kandidatja me shkollim të mesëm, andaj ajo kërkon që pasi të bëhet rivlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë të anulohet njoftimi për kandidaten e suksesshme duke e shpallur fituese ankuesen ose të rishpallet konkursi për këtë pozitë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ankesën e ankueses e ka proceduar me datë 13.09.2021 për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Me datë 04.10.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar 4664/2019 me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/66 faqe.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokollit 4900/2019 të datës 17.10.2019 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtën lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2728/2019 të datës 11.11.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, e pranuar me datë 12.12.2022 nga KPMSHCK-së me numër protokollit 7341/2022, dhe e ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK-në), që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankueses me numër A.nr. 588/2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.2728/2019 të datës 11.11.2022, e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën e datës 20.09.2019 e ankueses me numër protokollit 4423/2019, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK-në); Ankesa e datës 20.08.2019 drejtuar Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave; Vendimi me Nr.377/2019 i datës 29.08.2019 Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave; Vërtetimi i pranimit të aplikacionit e datës 26.06.2019; Diplomë Universitare e datës 25.02.2013 nr.3055; Certifikatë e notave e datës 18.01.2017 prej ½ faqe; Referencë e datës 25.10.2016; Certifikatë e datës 09.03.2011, për bazat e kompjuterit; Certifikatë e Gjykatës Themelore në Prishtinë, nga evidenca personale e datës 01.04.2019; Përgjigje në ankese e datës 04.10.2019 dhe në formë elektronike në e-mailin e datës 12.12.2019; Autorizimi i datës 20.06.2019 nga DASHC/MAP; Vendim NR.497/2019 i datës 11.07.2019 mbi themelimin e komisionit përzgjedhës së shërbimit civil; Regjistrimi i aplikacioneve i datës 09.07.2019; Lista e ngushtë e datës 18.07.2019; Vlerësimi individual i datës 25.07.2019 prej 1/10 faqe; Testi me shkrim i datës 18.07.2019 i ankueses dhe kandidatës së përzgjedhur; Raporti përmbledhës i datës 30.07.2019; Njoftimi i datës 31.07.2019; Aplikacioni i ankueses i datës 26.06.2019; Aplikacioni i datës 02.07.2019, Diploma e datës 23.06.1993, e lëshuar nga SH.M. "Luigj

Gurakuqi" në Klinë; Vërtetimi i datës 27.12.2017; Pasqyra e nxjerrë nga Trusti me datës 01.08.2019; Konkursi i shpallur me datës 25.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses Dafina Selmani, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankueses e cila pretendon se procedura e zhvilluar e rekrutimit për vendin e punës, është zhvilluar në kundërshtim me Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me rastin e vlerësimit të komisionit përzgjedhës si në testim me shkrim po ashtu dhe nga intervista me gojë, duke propozuar që ti bëhet rivlerësimi dhe të përzgjedhë kandidatë e suksesshëm më pas të anulohet njoftimi i kësaj procedure ose të rishpallet konkursi për këtë pozitë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses lidhur me procedurën e rekrutimit të zhvilluar sipas konkursit të datës 25.06.2019 për vendin e punës "Asistente Administrative", në QPD-së në Klinë pranë Drejtorisë për Pajisje me Dokumente-ARC në Ministrinë e Punëve të Brendshme, janë të pa bazuara sepse kriteret kualifikuese të konkurs kanë qenë: *Arsimi i mesëm trajnime përkatëse , së paku tri(3) vjet përvojë pune në fushën përkatëse ose administrative, ashtu siç përcaktohen në dispozitat ligjore të nenit 23 paragrafin 2 pikë 2.5 dhe 2.6 të Rregullore Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, që përcaktohet se: "2.5.Kërkohej shkollimi i mesëm dhe trajnimet në fusha përkatëse; 2.6. Përvojë në sistemet dhe procedurat përkatëse teknike ose administrative, së paku tri (3) vjet"*.

Pas shqyrtimit të gjithave provave të lëndës lidhur me pretendimet ankimore të ankueses dhe kriterëve të konkursit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në bazë të nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë në paragrafi 1 i këtij neni , që përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës"*, në të cilën listë është përfshirë ankuesja dhe kandidatja e përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, ka vepruar drejtë duke vlerësuar kandidatët e përfshirë në test me shkrim dhe me gojë, si për ankuesen po ashtu edhe për kandidaten e përzgjedhur, duke zbatuar dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në bazë të vlerësimeve kandidatja e përzgjedhur ka arritur që pas testit me shkrim dhe intervistës me gojë, të grumbullojë gjithsej 19.15 Pikë totale dhe është përzgjedhur kandidatë e suksesshëm, ndërsa ankuesja ka arritur gjithsej 74.5 pikë të përgjithshme nga testit me shkrim dhe testit me gojë dhe është renditur e dyta në listën e kandidatëve të suksesshëm, dhe me datë 31.07.2019 Ministria e Punëve të Brendshme, ka publikuar njoftimin përfundimtar nga procedura e rekrutimit duke vepruar në pajtim me nenin 41 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, siç përcaktohet se: *"Institucioni përkatës është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit në faqe të internetit të institucionit. Njoftimi përmban emrat e kandidatëve të suksesshëm,*

vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurë së përgjithshme”, dhe se pretendimet ankimore të ankueses lidhur me mos vlerësimin e drejt të vlerësimit nga testimi me shkrim dhe intervista me gojë, nga Komisioni përzgjedhës nga kjo procedurë të rekrutimit, nuk janë të qëndrueshme sepse është konstatuar se vlerësimi i testit me shkrim dhe intervistës me gojë, deri tek përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve, është bërë duke vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, ku është e përcaktuar se: „Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se përzgjedhja e kandidatëve është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”,* në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozite dhe në bazë të Formulari Form. MAP/SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve ankuesja pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritur gjithsejtë 75.5 pikët e përgjithshme, dhe është renditur e dyta(2) në listë, ndërsa kandidatja e përzgjedhur . nga testit me shkrim dhe testit me gojë, ka arritur të grumbulloj gjithsejtë 79.15 pikët e përgjithshme duke u renditur e para ne liste, dhe në bazë të kësaj dispozite, në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve të arritura nga testimi me shkrim dhe me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankueses se Komisioni Përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të arsimimit në krahasim me kandidaten e përzgjedhur, ky pretendim nuk është i qëndrueshëm sepse kandidatja e përzgjedhur ka arsimimin në pajtim me kriteret e konkursit të datës 25.06.2019 siç është kërkuar *„Arsimi i mesëm trajnime përkatëse”,* sepse kandidatja e përzgjedhur në vendin e punës *“Asistente Administrative”,* në QPD-së në Klinë, posedon Diplomë me numër protokolli 235 të datës 23.06.1993 të lëshuar nga Shkolla e Mesme „Luigj Gurakuqi” në Klinë me të cilën dëshmohet se ka kryer Shkollën e Mesme Juridike dhe ka marr titullin *„Teknik Juridik”* si dhe me përvojë të punës sipas Vërtetimit me numër protokolli 22/2017 të datës 27.12.2017 të lëshuar nga nga Komuna e Klinës e punësuar nga data 01.04.2011 deri me date 27.12.2017 në pozitën *Administratore për Pune Juridike dhe Administrative”* si dhe duke deklaruar edhe pasqyrën e llogarisë së Trustit Pensional.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën *“Asistente Administrative”,* është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanshinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe pretendimet e ankueses se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar konform ligjit dhe rregullores në fuqi, janë të pa qëndrueshme sepse Ministria e Punëve të Brendshme, procedurën e rekrutimit nga shpallja e konkursit të datës 25.06.2019 deri tek përzgjedhja përfundimtare e kandidatës në

pozitën "Asistente Administrative", e ka zhvilluar në pajtim me nenin 11 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.47/2019 me numër të protokollit 377/19 të datës 30.08.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave dhe të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.Nr.558/2019.

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtës



Malsore GASHI BAJRATARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.